

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegji i përberë nga gjyqtarët: Enver Peci, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Emine Kaçiku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në kontestin administrativ të paditësit "F." Sh.p.k. nga Prishtina, kundër të paditurës D. e K. (DK), me bazë juridike rivlerësimin e zhdoganimit të mallit, lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë AA.nr.307/2015 të dt:10.02.2016, në seancën e mbajtur më 28.04.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa e paditësit "F." Sh.p.k. nga Prishtina për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr.307/2015, datë 10.02.2016, kurse lënda i kthehet së njëjtës gjykatë për rigjykim.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA.nr.307/2015, datë 10.02.2016, është aprovuar si e bazuar ankesa e të paditurës D.K. në Prishtinë dhe është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.545/2014, datë 06.10.2015, ashtu që është refuzuar padia e paditësit "F." Sh.p.k dhe është vërtetuar aktvendimi i Doganës së Kosovës, nr.05.2.1/155,301, datë 24. 03. 2014.

Paditësi kësaj Gjykate i ka parashtrua brenda afatit ligjor kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston në tërësi ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA.nr.307/2015, datë 10.02.2016, për shkak të shkeljes së të drejtës materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën e kolegjit në baze të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe pas, vlerësimit të aktgjykimit të goditur, kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, konstatoi:

Kërkesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktvendimin nr. 05.2.1/155,301, datë 24. 03. 2014. të Doganës së Kosovës, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve, R 2633/07.02.2014, R 2954/12.02.2014 dhe R 2959/12.02.2014, të Zyrës Doganore Han i Elezit.

Duke vendosur mbi padinë e paditësit, parashtruar kundër vendimeve të përmendura të Z. D., të Hanit të Elezit, Gjykata Themelore Prishtine - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.545/14 datë 06.10.2015, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka anuluar aktvendimin nr.05.2.1/155,301 datë 24.03.2014, duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtine që si bazë për rillogaritjen e zhdoganimit të mallit lëndor, sipas DUD-ave R ..., R ... dhe R ... , të marrë vlerën e deklaruar të transaksionit realisht të paguar sipas faturave përcjellëse nr..., nr. ..., nr..., duke shtuar mbi këtë bazë shpenzimet e lejueshme si dhe t'ia rikthejë paditësit detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore të importit.

Gjykata e Apelit Prishtinë, me aktgjykimin AA.nr.307/2015, datë 10.02.2016, ka aprovuar ankesën e të paditurës Dogana e Kosovës, ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.545/14, datë 06.10.2015, ka refuzuar padinë e paditësit "F." Sh.p.k. dhe ka vërtetuar aktvendimin nr.05.2.1/155,301, datë 24.03.2014.

Lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit Prishtinë sa i përket aktgjykimin të kontestuar, për shkak se ai është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale dhe me zbatimin të gabuar të drejtës materiale, që janë me ndikim në zgjidhjen e çështjes.

Gjykata Supreme vlerëson se aktgjykimi i atakuar përmban shkelje të dispozitave të nenit 182 par.2 pika (n) të LPK, i zbatueshëm në bazë të nenit 63 të LKA. Dispozita e këtij neni përcakton se shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale ekzistojnë gjithmonë kur aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave ai nuk mund të ekzaminohet e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimin është i pakuptueshëm apo kontradiktor në vetvete ose me arsyet e aktgjykimin apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye ose në të nuk janë paraqitur fare arsyet për faktet vendimtare ose ato arsye janë të paqarta a kontradiktore ose kur për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie mes asaj që thuhet në arsyet e aktgjykimin për përmbajtjen e dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose procesverbalit.

Shkeljet thelbësore konsistojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimin është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyet ligjore në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së dytë. Nga përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimin të kontestuar, gjykata e shkallës së dytë konstaton një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në një situatë të këtillë procedurale, gjykata e shkallës së dytë është dashur ta përshtatë dispozitën e nenit 195.1 e) të LPK, në të cilën thuhet shprehimisht se gjykata e ankimimit mundet në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes, mes tjerash, "ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë". Në dispozitivin e aktgjykimin kontestues gjykata e shkallës së dytë e aprovoi ankesën e të paditurës, pastaj e anulon aktgjykimin e shkallës së parë, refuzoi padinë e paditësit dhe e vërtetoi aktvendimin kontestues administrativ të së paditurës. Dispozita e nenit 195 e LPK në të cilin bazohet aktgjykimin i kontestuar në mënyrë të detajuar dhe një për një përcakton se si do të veprojë gjykata e shkallës së dytë. Nga dispozitivi i aktgjykimin të kontestuar gjykata e shkallës së dytë e anuloi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, gjë që e ka bërë me të drejtë, mirëpo neni 195.1 pika b) saktëson se, nëse prishet

aktgjykimi i goditur, mund të hidhet poshtë padia (është e kuptueshme në cilat raste mund të hidhet poshtë padia), ndërsa pika c) e këtij neni përcakton se, nëse gjykata e prish aktgjykimin, çështjen e kthen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së dytë e refuzoi padinë e paditësit dhe e vërtetoi aktvendimin e të paditurës, kurse në dispozitiv nuk veptoi sipas deponitës se pikës e) të nenit 195 .1. të LPK, e cila përcakton qartë se gjykata e ankimimit “mund a ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë”. Për këto arsye, ky dispozitiv është i paqartë dhe kontradiktor me arsyetimin, i cili kryesisht bazohet në këtë situatë procedurale të parashikuar nga neni 201.1 pika b) të LPK, ngase gjykata e shkallës së dytë i ka vlerësuar shkresat dhe provat ndryshe nga gjykata e shkallës së parë dhe ka konstatuar një gjendje tjetër faktike.

Duke i vlerësuar pretendimet e paditësit lidhur me shkeljen e së drejtës materiale të parashikuar nga neni 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës (KDA) dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me aplikimin e nenit 35 të KDA mbi vlerën doganore të mallrave të importuara, të metodës VI, pastaj arsyet e dhëna në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë që konsideron se duhet aplikuar neni 33-35 të KDA për këtë vlerësim, kjo Gjykatë konsideron se në këtë çështje administrative ka nevojë për sqarime shtesë sa i përket vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, vlerëson po ashtu, se ka kundërthënie dhe interpretime të ndryshme rreth kësaj çështjeje kyçe kontestuese. Gjykata e shkallës së dytë konstaton, mes tjerash, se përmbajtja e vendimit të së paditurës D. e K. dhe shkresave të tjera të lëndës vërteton në mënyrë të plotë gjendjen faktike të kësaj çështjeje, duke vlerësuar, siç thuhet në aktgjykim, se nga e paditura me të drejtë është refuzuar kërkesa për t’u pranuar dokumentacioni përcjellës i mallit, ngase në bazë të të dhënave që disponoheshin në Sektorin e vlerës së të paditurës janë përpiluar çmimet për mallin lëndor, duke konsideruar si jorelevant dokumentacionin përcjellës. Aktgjykimi i atakuar bazohet ekskluzivisht në shkresën e Sektorit të vlerës së të paditurës, datë 05.02.2014, përpiluar nga e paditura Dogana e Kosovës, përmbajtja e së cilës, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk mund të konsiderohet si një bazë e mjaftueshme për vlerësimin e mallrave të importuara sipas KDA. Përmbajtja e shkresës bazohet në një takim të mbajtur mes Shoqatës për Importimin dhe Eksportimin e Bagëtisë “Gj.” dhe D. e K. më 04.02.2014. Sektori i vlerës me këtë rast vetëm propozon çmimet si vlera referente që duhen aplikuar në import, andaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate vetëm një shkresë me të cilën propozohen çmimet si vlera referente, nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme gjendjen faktike, siç pretendon gjykata e shkallës së dytë. Në rastin konkret, bëhej fjalë vetëm një propozim, ndërsa më tutje nuk kemi ndonjë vendim të vlefshëm të së paditurës lidhur me këtë. KDA në asnjë dispozitiv ligjor nuk parashikon se duhet bërë vlerësimi i mallit në bazë të një propozimi, siç është në rastin konkret Sektori i vlerës, por në bazë të këtij Ligji, prandaj aktgjykimi i atakuar në këtë rast është i mangët dhe nuk përmban arsye bindëse dhe të argumentuara për të konstatuar se është aplikuar drejt dispozita e nenit 35 të KDA dhe në këtë mënyrë konsiderohet se është bërë edhe shkelja e së drejtës materiale, e dispozitave të KDA.

Shkeljet të tilla janë shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe materiale, që kanë pasur ndikim në mosmarrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë, prandaj aktgjykimi i atakuar doemos u desh të anulohet.

Gjykata e shkallës së dytë, me rastin e rigjyimit, duhet t'i mënjanojë mangësitë e cekura me lart, në mënyrë që dispozitivin e aktgjyimit ta përpilojë në bazë të dispozitave të parashikuara ligjore dhe të mos lejojë kundërthënie mes këtyre dispozitave dhe arsyeve të cekura në aktgjykim, pastaj lidhur me faktet vendimtare t'i vërtetojë të gjitha faktet relevante ashtu që vendimin ta bazojë në të gjitha provat që ndodhen në shkresat e lëndës dhe të japë arsye bindëse për secilën provë në përshtatje me të drejtën materiale, për të marrë në fund një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga sa u tha me sipër, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 54 par.2 dhe 3 të Ligjit për Konflikte Administrative, vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Më 2 prill 2016, ARJ.nr.15/2016

Procesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Enver Peci